



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3125/ 13 prot

Datë 03/02/2026

V E N D I M
Nr. 190/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03/02/2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Korsef” SHPK dhe operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-58215-08-15-2025 me objekt “Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum” me fond limit 27,910,435.00 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 287,085.32 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) euro pa TVSH, Kursi këmbimit 97.22 lekë, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”, Vlorë.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Rej” SHPK, me NUIS J93711608Q, me adresë rruga “Dritan Hoxha”, Kulla Jeshile ngjitur me shkollën “Ahmet Gashi”, Nr. 8/374/ND+3-6, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Pastime Silvio” SHPK me NIPT K91413010N dhe me adresë: Rruga “Fatmir Haxhiu”, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “Korsel” SHPK me NIPT J64104124G dhe me adresë: Lagjja 17, Rruga “Midhi Kostani”, Pranë Hipotekës, Objekti Nr. 23, Korçë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.08.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-58215-08-15-2025 me objekt “Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum” me fond limit 27,910,435.00 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 287,085.32 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) euro pa

TVSH, Kursi këmbimit 97.22 lekë, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 22.09.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 10.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Pastrime Silvio” SHPK	22,299,304.8	lekë	kualifikuar
2. “Korsel” SHPK	22,931,011.2	lekë	kualifikuar
3. “Rej” SHPK	22,949,485.12	lekë	kualifikuar
4. “Alko Impex Construction” SHPK	23,163,321.60	lekë	kualifikuar
5. “Silver” SHPK	23,365,368	lekë	kualifikuar
6. “Cara” SHPK	25,119,651.2	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 24.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 03.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6037 dhe nr. 3125/2025 protokolli, datë 03.11.2025 e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Korsel” SHPK dhe operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat si vijon:

Së pari, Operatori Pastrime Silvio shpk është kualifikuar në vendin e parë të kësaj procedure prokurimi dhe pas kërkesës së bërë prej autoritetit kontraktor, me qëllim dorëzimin e dokumentacionit origjinal ose të noterizuar, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “RRP” të ndryshuar, nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin provues për secilën prej rubrikave të vetëdeklaruar në Formularin përmbledhës së Vetdeklarimit. Nisur nga procedurat e mëparëshme, kemi vërejtur se ky operator është skualifikuar për mosdorëzimin e dokumentave të vetdeklaruar prej tij në formularin përmbledhës së vetdeklarimit, Shtojca 10.

- Konkretisht, OE Pastrime Silvio shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. (Vertetim i Gjendjes gjyqësore të Subjektit i lëshuar nga Drejtoria e përgjithshme e Burgjeve).

- OE Pastrime Silvio shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Gjithashtu, operatori Pastrime Silvio shpk nuk ka plotësuar saktë Formularin përbledhës së Vetdeklarimit, duke iu dhënë përgjigje të gjitha fushave të rubrikës Pjesa I: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit. Mungesa e plotësimit të rubrikave për të cilën operatori ekonomik ka detyrimin të identifikojë institucionin lëshues të dokumentit për të cilin e kërkon rubrika, me qëllim që autoriteti kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit të deklarimit të dhënë e bën ofertën të skualifikueshme për mos plotësim të saktë të formularit përmbledhës së vetdeklarimit.

Së dyti, në pikën 2.3.3, të Kapacitetit Teknik të DT-ve, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Drejtues Teknik-Inxhinier Mjedisi	1 (një)
Pergjegjes Shërbimi	1 (një)
Punonjes shërbimi(5 punetor fshese + 4 punonjes per transport mbeturinash)	9(nëntë)
Shofer per drejtimin e mjeteve te kerkuara	3 (tre)
Totali i punonjësve	14 (katërmëdhjetë)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

➤ **Për Drejtuesin Teknik, Inxhinier mjedisi**

OE duhet te paraqes:

- Diplomë me profesion **Menaxhim mjedisi**
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune
- CV

➤ **Per Pergjegjes Shërbimi,**

OE duhet te paraqes:

- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune.
- CV.

➤ **Per punonjes shërbimi (Punetor fshese & punonjes per transport mbeturinash)**

OE duhet te paraqes:

- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune.

➤ **Per punonjësit Shofer të paraqitet**

OE duhet te paraqes:

- Kontrate pune perkatese.

- Leje drejtimi përkatëse nga DPSHTRR për mjetet objekt i kontrates, të cilat duhet të jenë të vlefshme.
- Librezë pune.

* *Shenim: Kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listat e operatorit ekonomik ofertues.*

Keto kërkesa do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të sipërcituar).

Operatori Pastrime Silvio shpk në formularin përmbledhës së vetdeklarimit ka deklaruar se disponon të punësuar një Inxhinier Mjedisi, profili Menaxhim Mjedisi, si Drejtues Teknik, por nga verifikimi i deklarimeve të bëra në ekstraktin e regjistrimit tregëtar të QKB nuk rezulton i deklaruar drejtuesi teknik, një detyrim ky në rastin e punësimeve të inxhinierëve të cilat janë të detyrueshëm për të marrë licencën III.2.B. Në këto kushte operatori Pastrime Silvio shpk nuk përmbush kriterin për disponimin e një inxhinieri Mjedisi, profili për Menaxhim Mjedisi të punësuar si Drejtues Teknik dhe që të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit sikurse e parashikon kriteri i pikës 2.3.4 sipas të cilit të gjithë punonjësit e deklaruar në përmbushje të kriterit të pikës 2.3.3 duhet të figurojnë të punësuar në listëpagesat e tre muajve të fundit të shoqërisë nga data e publikimit të procedurës.

Operatori Pastrime Silvio shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës së vetdeklarimit disponimin e një përgjegjësi shërbimi, por kur ka dorëzuar listëpagesat nuk rezulton që ky përgjegjës shërbimi të jetë i punësuar 3 muajt e fundit, dhe për më tepër nuk rezulton i punësuar si i tillë me kodin e deklaruar në listëpagesë referuar VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për listën kombëtare të profesioneve” të ndryshuar.

Operatori Ekonomik Pastrime Silvio shpk nuk disponon minimalisht 3 shoferë të punësuar e të pajisur me leje drejtimi për mejtet e kërkuara në pikën 2.3.5. Përkundrazi autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar se me çfarë kategorie të leje drejtimi duhej të dispononin shoferët e deklaruar, por referuar mjeteve të kërkuara në pikën 2.3.5 duhet që shoferët të disponojnë minimalisht kategorinë “C” të patentës / leje drejtimit dhe të jenë të pajisur me certifikatë për aftësinë Profesionale (CAP) për drejtimin e këtyre mjeteve teknologjike. Autoriteti kontraktor ka vlerësuar të ligjshme në mënyrë të padrejtë leje drejtimit e dorëzuara nga Pastrime Silvio shpk për tre shoferët e deklaruar të cilët janë të pajisur me kategorinë e lejës së drejtimit B.

Veprim ky që vjen në kundërshtim me vetë kriterin dhe me Kodin Rrugor të republikës së shqipërisë.

Së treti, në pikën 2.3.5, të Kapacitetit Teknik të DT-ve, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor, me kapacitet jo më të vogël se 15 m ³ ,	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncine transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo më pak se 3.5 ton,	Cope	1 (nje)	Në pronësi ose me qira
3	Makinë teknologjike larëse (autobot) me kapacitet jo më pak se 17 m ³	Cope	1 (nje)	Në pronësi ose me qira
4	Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) Dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m ³ .	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) e vlefshme
- d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)
- f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen)
- g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:

- a) Kontrata e qerasë
- b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

- c) *Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) (e vlefshme)*
 - d) *Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
 - e) *Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)*
 - f) *Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen)*
 - g) *Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (**fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira**)*
 - *Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).*
 - *Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.*
 - *Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. **Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi.** Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*
 - *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Kualifikimi i ofertës së Pastrime Silvio shpk është bërë në kundërshtim me kriterin e pikës 2.3.5 pasi nga verifikimi i ekstraktit tregëtar të QKB, rezulton se ky subjekt ka deklaruar se disponon vetëm dy makina teknologjike, ndërsa në kriterin e pikës 2.3.5 kërkohen që subjektet të disponojnë 3 dhe që të jenë të pajisura me dokumentacionin e përcaktuar në gërmat “a” – “g” kur janë në pronësi dhe “a” – “g” kur janë me qira.

Nisur nga mungesa e deklarimit të 3 makinave teknologjike të deklaruar në QKB krijojmë bindjen se subjekti Pastrime Silvio shpk nuk e plotëson kriterin për disponimin e 3 makinave teknologjike të pajisura me dokumentacionin e kërkuar në këtë pikë. Gjithashtu, nga verifikimet tona të bëra në deklarimet që vet subjekti Pastrime Silvio shpk ka bërë në ekstraktin e regjistrit tregëtar të QKB, rezulton se ky subjekt nuk disponon një Kamioncine transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo me pak se 3.5 ton, të pajisur me dokumentacionin e kërkuar. Edhe ne kushtet e marrjes me qira të kësaj komioncinë, ajo nuk disponon certifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi të lëshuar për qiradhënësin e cila të cilësojë se është e pajisur me Certifikatë Transporti për vetë dhe për të tretë.

Lidhur me kualifikimin e padrejtë të Korsel shpk

Së pari, Korsel shpk nuk ka plotësuar saktë Formularin përbledhës së Vetdeklarimit, duke iu dhënë përgjigje të gjitha fushave të rubrikës Pjesa I: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për Përbushjen e Krieteve të Përgjithshme të Kualifikimit. Mungesa e plotësimit të rubrikave për të cilën operatori ekonomik ka detyrimin të identifikojë institucionin lëshues të dokumentit për të cilin e kërkon rubrika, me qëllim që autoriteti kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit të deklarimit të dhënë e bën ofertën të skualifikueshme për mos plotësim të saktë të formularit përmbledhës së vetdeklarimit.

Operatori Korsel shpk nuk disponon të gjithë dokumentacionin provues për secilën prej rubrikave të vetëdeklaruar në Formularin përmbledhës së Vetdeklarimit. Nisur nga procedurat e mëparëshme, kemi vërejtur se ky operator është skualifikuar për mosdorëzimin e dokumentave të vetdeklaruar prej tij në formularin përmbledhës së vetdeklarimit, Shtojca 10.

- Konkretisht, Korsel shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. (Vertetim i Gjendjes gjyqësore të Subjektit i lëshuar nga Drejtoria e përgjithshme e Burgjeve).

- OE Korsel shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Së dyti, në pikën 2.2.2, të Kapacitetit Ekonomik të DT-ve, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm:

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, ne perputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se). Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët

ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalinë.

Nga verifikimi i ekstraktit tregëtar të shoqërisë Korsel shpk mbi adresat e deklaruara në QKB, rezulton se ky subjekt ka të deklaruara një adresë kryesore të selisë që është në qytetin e Korcës dhe 3 adresa të tjera dytësore në qytetet Maliq, Tiranë, dhe Vlorë. Në përmbushje të detyrimit të kriterit të pikës 2.2.2 të kapacitetit ekonomik, operatori Korsel shpk ka deklaruar se i ka paguar të gjitha detyrimet për taksat vendore për vitin 2025 në të gjitha adresat ku figuron i regjistruar në QKB por këtë deklaram nuk e provon me dokumentacion apo me vërtetim të lëshuar nga këto 4 Bashki që provon likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2025.

Së treti, në pikën 2.3.3, të Kapacitetit Teknik të DT-ve, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm:
 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Drejtues Teknik-Inxhinier Mjedisi	1 (një)
Pergjegjes Shërbimi	1 (një)
Punonjes sherbimi(5 punetor fshese + 4 punonjes per transport mbeturinash)	9(nëntë)
Shofer per drejtimin e mjeteve te kerkuara	3 (tre)
Totali i punonjësve	14 (katërbëdhjetë)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

➤ **Për Drejtuesin Teknik, Inxhinier mjedisi**

OE duhet te paraqes:

- Diplomë me profesion **Menaxhim mjedisi**
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune
- CV

➤ **Per Pergjegjes Shërbimi,**

OE duhet te paraqes:

- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune.
- CV.

➤ **Per punonjes sherbimi (Punetor fshese & punonjes per transport mbeturinash)**

OE duhet te paraqes:

- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune.
- Per punonjësit Shofer të paraqitet

OE duhet te paraqes:

- Kontrate pune perkatese.
- Leje drejtimi përkatëse nga DPSHTRR per mjetet objekt i kontrates, te cilat duhet te jene te vlefshme.
- Librezë pune.

**Shenim: Kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund te disponohen së bashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë te jene te perfshire ne listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.*

Keto kërkesa do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të sipërcituar).

Operatori Korsel shpk ka deklaruar në formualrin përmbledhës së vetdeklarimit disponimin e një përgjegjësi shërbimi, por kur ka dorëzuar listëpagesat nuk rezulton që ky përgjegjës shërbimi të jetë i punësuar 3 muajt e fundit, dhe për më tepër nuk rezulton i punësuar si i tillë me kodin e deklaruar në listëpagesë referuar VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për listën kombëtare të profesioneve” të ndryshuar. Operatori Ekonomik Korsel shpk nuk disponon minimalisht 3 shofer të punësuar e të pajisur me leje drejtimi për mejtet e kërkuara në pikën 2.3.5. Paska se autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar se me çfare kategorie të leje drejtimi duhej të dispononin shoferët e deklaruar, por referuar mjeteve të kërkuara në pikën 2.3.5 duhet që shoferët të disponojnë minimalisht kategorinë “C” të patentës / leje drejtimit dhe të jenë të pajisur me Certifikatë për Aftësinë Profesionale (CAP) për drejtimin e këtyre mjeteve teknologjike. Autoriteti kontraktor ka vlerësuar të ligjshme në mënyrë të padrejtë leje drejtimit e deklaruar për tre shoferët të cilët janë të pajisur me kategorinë e lejës së drejtimit B. Veprim ky që vjen në kundërshtim me vetë kriterin dhe me Kodin Rrugor të republikës së shqipërisë.

Së katërti, në pikën 2.3.5, të Kapacitetit Teknik të DT-ve, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm: 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
----	---------------	--------	-----------------	---------

1	Makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor, me kapacitet jo me te vogel se 15 m3,	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncine transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo me pak se 3.5 ton,	Cope	1 (nje)	Në pronësi ose me qira
3	Makinë teknologjike larëse (autobot) me kapacitet jo më pak se 17 m3	Cope	1 (nje)	Në pronësi ose me qira
4	Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) Dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m3.	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- h) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- i) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- j) Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) e vlefshme
- k) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- l) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)
- m) Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen)
- n) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:

- h) Kontrata e qerasë
- i) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- j) Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) (e vlefshme)
- k) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- l) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)
- m) Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen)
- n) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (**fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira**)
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. **Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi.** Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Kualifikimi i ofertës së Korsel shpk është bërë në kundërshtim me kriterin e pikës 2.3.5 pasi nga verifikimi i ekstraktit tregëtar të QKB, rezulton se ky subjekt nuk ka të deklaruar asnjë makineri teknologjike ndërsa në kriterin e pikës 2.3.5 kërkohen që subjektet të disponojnë 3 makina teknologjike dhe që të jenë të pajisura me dokumentacionin e përcaktuar në gërmat "a" – "g" kur janë në pronësi dhe "a" – "g" kur janë me qira. Nisur nga mungesa e deklarimit të 3 makinave teknologjike të deklaruar në QKB krijojmë bindjen se subjekti Korsel shpk nuk e plotëson kriterin për disponimin e 3 makinave teknologjike të pajisura me dokumentacionin e kërkuar në këtë pikë. Gjithashtu, nga verifikimet tona të bëra në deklarimet që vet subjekti Korsel shpk ka bërë në ekstraktin e regjistrat tregëtar të QKB, rezulton se ky subjekt nuk disponon një Kamioncine transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo më pak se 3.5 ton, të pajisur me dokumentacionin e kërkuar. Edhe në kushtet e marrjes me qira të kësaj komioncinë, ajo nuk disponon çertifikatë transporti nga njësi vendore për mjetet që duhet ta

disponojnë sipas dispozitave në fuqi të lëshuar për qiradhënësin e cila të cilësojë se është e pajisur me Certifikatë Transporti për vetë dhe për të tretë.

Sa më sipër perfundimisht kërkohet:

A-) Pranimin e ankesës.

B-) Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit Pastrime Silvio shpk dhe Korsel shpk, duke i skualifikuar ato.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3125/1 prot, datë 04.11.2025 me kriteret që operatori ekonomik “Rej” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Korsel” SHPK dhe operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr. 3125/2025 prot, datë 03.11.2025.

II.7. Me shkresën nr. 18441/2 prot, datë 07.11.2025, me objekt “Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokoll 3125/2025”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3125/2 prot., datë 10.11.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka dërguar vendimin e KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Rej” SHPK. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se pretendimet e ankimesit janë refuzuar.

II.8. Me shkresën nr. 18441/2 prot, datë 07.11.2025, me objekt “Vendim lidhur me ankesën me Numër Protokoll 3125/2025”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3125/3 prot., datë 10.11.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka dërguar vendimin e KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Rej” SHPK. Referuar të cilit rezulton se KSHA-së ka refuzuar pretendimet e ankimesit. Gjithashtu autoriteti kontraktor bashkalidhurshkresës së sipërcituar ka dërguar edhe dokumentacionin e operatorit ekonomik fitues.

II.9. Me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 1736/2025 datë 20.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të urdhëroj paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, nga ana e subjektit “Korsel” SHPK, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e vecanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-58215-08-15-2025, me objekt “Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum”, me fond limit 27,910,435 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 287,085.32 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) euro pa TVSH, sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 15.08.2025 ku 1*

Euro këmbëhet me 97.22 lekë, zhvilluar me datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

2. *Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 26.11.2025.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.10. Në lidhje me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 1736/2025 datë 20.11.2025, nga operatori ekonomik “*Korsel*” SHPK, nuk është dërguar asnjë informacion.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor u konstatua se, pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar formulari argumentave nr 3125/7 prot, datë 03.12.2025 dhe nr. 3125/8 prot, datë 05.12.2025 nga subjekti i interesuar “*Rej*” SHPK në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

II.12. Me qëllim shqyrtimin e ankesën e operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 3125/9 prot., datë 13.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik i kualifikuar i par, në lidhje me vërtetueshmërinë e deklarimeve në shtojcën 10 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

II.13. Me shkresën nr. 936/1 prot, datë 19.01.2026, me objekt “Dorëzim dokumentacioni”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3125/10 prot., datë 23.01.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka dërguar informacion dhe dokumentacion gjithësej 1496 në zbatim të shkresës nr. 3125/9 prot, datë 13.01.2026 të Komisionit Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Rej*” SHPK ku kërkon shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Korsel*” SHPK, Komisioni me Vendimin e Ndërmjetëm nr. 1736/2025 datë 20.11.2025, iu drejtua operatorit ekonomik “*Korsel*” SHPK, duke i kërkuar paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në lidhje me këtë kërkesë drejtuar operatorit ekonomik të interesuar nëpërmjetë Vendimit të Ndërmjetëm me nr. 1736/2025 datë 20.11.2025, nga operatori ekonomik “*Korsel*” SHPK, nuk është dërguar asnjë

informacion deri në ditën e marrjes së këtij vendimi. Operatori ekonomik “Korsel” SHPK, nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të kërkuar, si dhe brenda çdo afati të arsyeshëm ligjor. Referuar pikës 1 të nenit 82 “1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj dhe pikës 4 të nenit 94 “4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin 91 të këtij Kodi” Ligj Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, barra e provës i përket operatorit ekonomik “Korsel” SHPK, si palë e interesuar në këtë proces, i cili ka dështuar për të sjellë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këto kushte, duke qenë se operatori ekonomik “Korsel” SHPK, si palë e interesuar, ka qenë pasiv dhe jobashkëpunues në dhënien e informacionit të kërkuar, Komisioni nuk do të marrë në shqyrtim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK. Konkretisht, Komisioni konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Korsel” SHPK, janë pretendime që nuk mund të verifikohen nga burime të hapura. Por është detyre e operatorit ekonomik “Korsel” SHPK, si subjekt i interesuar që të sjellë dokumentacionin provues. Në rastet e shqyrtimit të ankesave nga KPP, kur kjo nga praktika e konsoliduar është treguar proaktive në kërkim të informacionit të deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetdeklarimit në SPE, për tu dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Korsel” SHPK. Ky i fundit refuzoi bashkëpunimin me KPP, duke bërë të pamundur verifikimin e deklartave të bera nga operatori ekonomik “Korsel” SHPK, kur ky i fundit ka dështuar të provojë që përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, dhe së dyti certifikatat/dëshmitë e kualifikimit të punonjësve, verifikimi i mjeteve të deklaruara. Sa më sipër, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë këtë operator ekonomik nga procedura e prokurimit.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e pa drejtë të operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK me arsyen se: “Së pari, Operatori Pastrime Silvio shpk është kualifikuar në vendin e parë të kësaj procedure prokurimi dhe pas kërkesës së bërë prej autoritetit kontraktor, me qëllim dorëzimin e dokumentacionit origjinal ose të noterizuar, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “RRP” të ndryshuar, nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin provues për secilën prej rubrikave të vetdeklaruar në Formularin përmbledhës së Vetdeklarimit. Nisur nga procedurat e mëparëshme, kemi vërejtur se ky operator është skualifikuar për mosdorëzimin e dokumentave të vetdeklaruara prej tij në formularin përmbledhës së vetdeklarimit, Shtojca 10. - Konkretisht, OE Pastrime Silvio shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. (Vertetim i Gjendjes gjyqësore të Subjektit i lëshuar nga Drejtoria e përgjithshme e Burgjeve). - OE Pastrime Silvio shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i

tij ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Gjithashtu, operatori Pastrime Sivlio shpk nuk ka plotësuar saktë Formularin përmbledhës së Vetdeklarimit, duke iu dhënë përgjigje të gjitha fushave të rubrikës Pjesa I: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për Përmbushjen e Krieteve të Përgjithshme të Kualifikimit. Mungesa e plotësimit të rubrikave për të cilën operatori ekonomik ka detyrimin të identifikojë institucionin lëshues të dokumentit për të cilin e kërkon rubrika, me qëllim që autoriteti kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit të deklarimit të dhënë e bën ofertën të skualifikueshme për mos plotësim të saktë të formularit përmbledhës së vetdeklarimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit. A: “Deklarata për përmbushjen e krieteve të përgjithshme të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/>
<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-</p>

<p>vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>
<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime _____ *nëse* _____ *vlerësohet* _____ *e*
nevojshme _____

III.1.2. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “c” dhe “e” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

[...]

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike si dokumentacionit të dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari “Pastrime Silvio” SHPK, konstatohet se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK ka dorëzuar:

- Shtojca 10 Formualri Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

***jesa II: Shkaqet e përjashtimit**

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<p>Deklarata</p> <p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Ekstrakt i thjeshtë QKB</u></i></p> <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Vërtetim i gjendjes gjyqësore i subjektit</u></i></p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: Bule Adem Merjeme Allmuça; Vendlindja: Balhaxhias, Tiranë; Dtl 29.06.1974; nr. ID: 034215286 dhe nr. personal: H456290440</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Vërtetim i gjendjes gjyqësore i administratorit</u></i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Vërtetim nga gjykata (civile + penale)</u></i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Vërtetim statusi aktiv</u></i></p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a</u></i></p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Vërtetim debie</u></i></p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Vërtetime për realizimin me sukses të kontratave</u></i></p>
<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Ekstrakt nga regjistri i pronarit përfitues</u></i></p>
<p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Listëpagesa Esig-25</u></i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p>
<p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Buletini i Prokurimit Publik - Operatorët ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe Vërtetim mospërjashtimi nga APP</u></i></p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme <u>Certifikata ISO 9001:2015 (Sistemet e menaxhimit të cilësisë); ISO 14001:2015 (Sistemet e menaxhimit mjedisor); ISO 45001:2018 (Sistemet e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë); Licencë me kod III.2.A (1+2) për Shërbime ekspertize lidhur me ndikimin në mjedis (auditim mjedisor, vlerësim i ndikimit në mjedis); Licencë me kod III.2.B për transport të mjetëve jo të rrezikshme; Licencë me kod II.8.A për shërbime ekspertize higjeno-shëndetësore; Licencë me kod II.8.B për Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore; Licencë me kod II.8.C për Veprimtari në fushën e Shëndetit Publik që nuk liçencohen sipas një kategorie tjetër; Licencë III.7.A për shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota; Licencë I.2.A për Shërbime ekspertize për: Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat kundra zjarrit të ndërtesave të çdo lloji</u></i></p>

- Dokumentacioni fizik i operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 18441/2 prot, datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3125/3 prot, datë 13.11.2025, si shkresës nr. 936/1 prot, datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3125/10 prot datë 23.01.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionin prej 124 faqe dhe 1496 faqe të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK, ku ndër të tjera është dorëzuar edhe dokumenti: Vërtetim debie nr. VD000020049, datë 14.10.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. B. A, vërtetohet se klienti Pastrime Silvio SHPK nga verifikimet e kryera në sistemin tonë të faturimit, për kontratat, (me kod) AL0089998, TR1B120001100810, TR3M200029621120,, titullar/përdorues i të cilave është Pastrime Silvio SHPK, nuk rezulton debitor për faturat e energjisë elektrike pranë shoqërisë FSHU SHA.

- Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 11 prot, datë 08.09.2025 për subjektin Pastrime Silvio SHPK me NIPT K91413010N, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky subjekt është i Pa Dënuar.

III.1.4 . Në nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5- vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja

detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji. 19

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik

të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm

ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi19;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për

dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Në rastin konkret referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “*Rej*” SHPK, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në këtë formular, vërehet se operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK ka dhënë informacion për plotësimin e të gjithë rubrikave të mësipërme që lidhen me plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit duke përcaktuar dokumentin konkret, autoritetin lëshues apo dokumentin konkret të institucionit nga janë siguruar të dhënat duke dhënë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi në fazën tjetër të vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar në autoritet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke dhënë të dhënat e nevojshme për rubrikat e cituara më sipër në këtë vendim sic ky formular parashikon. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet

e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK ka plotësuar të gjitha rubrikat e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kritereve të përgjithshme të kualifikimit në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator si dhe me dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objket ankimi.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, A, parashikohet “*Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme*”. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës nr. 18441/2 prot, datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3125/3 prot, datë 13.11.2025, si dhe shkresës nr. 936/1 prot, datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3125/10 prot datë 23.01.2026, gjithësej 124 faqe dhe 1496 faqe, Komisioni i Prokurimit Publik pasi verifikoi dokumentacionin e ardhur nga autoriteti kontraktor konkretisht dokumentin “*Vërtetim debie nr. VD000020049, datë 14.10.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. B. A, vërtetojmë se klienti Pastrime Silvio SHPK nga verifikimet e kryera në sistemin tonë të faturimit, për kontratat, (me kod) AL0089998, TRIB120001100810, TR3M200029621120,, titullar/përdorues i të cilave është Pastrime Silvio SHPK, nuk rezulton debitor për faturat e energjisë elektrike pranë shoqërisë FSHU SHA. , si dhe pretendimeve të ankimuesit, rezulton se vërtetimi sipërcituar i FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal) ka 3 kontrata aktive me OSHE, për të cilat referuar vërtetimit të sipërcituar rezulton se nuk ka detyrime të papaguara.*

III.1.9. Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “*11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.*”

III.1.10 Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: *“13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”*

III.1.11 KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë tij, si dhe duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, lidhur me një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, dhe pasi verifikoi dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor konkretisht dokumentin *“Vërtetim debie nr. VD000020049, datë 14.10.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruës...z. B. A, vërtetohet se klienti Pastrime Silvio SHPK nga verifikimet e kryera në sistemin tonë të faturimit, për kontratat, (me kod) AL0089998, TR1B120001100810, TR3M200029621120,, titullar/përdorues i të cilave është Pastrime Silvio SHPK, nuk rezulton debitor për faturat e energjisë elektrike pranë shoqërisë FSHU SHA. ”*. Referuar informacionit të dhënë nga Furnizuesi Shërbimit Universal Sh.A., i cili menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike, për të gjithë kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike, me anë të së cilës vërtetohet, se subjekti *“Pastrime Silvio” SHPK* nuk rezulton debitor për 3 kontratat, përfshirë, Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik *“Pastrime Silvio” SHPK* me dokumentacionin e dorëzuar në autoritetin kontraktor, i cili shërben si provë për vërtetimin e deklaratimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmush kërkesat e autoritetit kontraktor. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për përmushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, operatori ekonomik *“Pastrime Silvio” SHPK* ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së, nga verifikimi i të cilave rezulton se operatori ekonomik *“Pastrime Silvio” SHPK* i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu nisur nga pretendimet më sipër të ankimuesit, për skualifikimin e operatorit ekonomik *“Pastrime Silvio” SHPK*, për shkak se nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale (Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore të Subjektit i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve). Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik *“Pastrime Silvio” SHPK*, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit ka kryer deklaratimet në cdo fushë të tij. Duke qenë se operatori ekonomik *“Pastrime Silvio”*, sipas vendimit të KVO-së është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr. 18441/2 prot, datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3125/3 prot, datë 13.11.2025, si dhe shkresës nr. 936/1 prot, datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3125/10 prot datë 23.01.2026, gjithësej 124 faqe dhe 1496 faqe, në brendësi të të cilit gjendet dokumentecioni për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit objekt ankese si më poshtë: “Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 11 prot, datë 08.09.2025 për subjektin Pastrime Silvio SHPK me NIPT K91413010N, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky subjekt është i Pa Dënuar”. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, dhe duke i ballafaquar me kriteret e përgjithshme të kualifikimit, dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, si dhe dokumentacionin fizik të paraqitur pranë autoritetit kontraktor për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në autoritetin kontraktor, i cili shërben si provë për vërtetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni vëren, se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK ka dorëzuar Vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për subjektin që nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së. Sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK ka plotësuar rubrikën Pjesa II Shkaqet e përjashtimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit duke dhënë informacionin që ky formular kërkon, si dhe ka paraqitur dokumentacion për këtë kriter pranë autoritetit kontraktor referuar informacionit të dërguar nga ky i fundit në KPP.

Në këtë kuadër, operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK i kualifikuar i pari, nga verifikimi i dokumentacionit provues të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të cilat si më sipër kanë shëbryer si objekt i ankesës dhe nga deklaratimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e këtyre kriterëve, konsiderohet dokumentacion i vlefshëm, duke përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Rej” SHPK se: “Në pikën 2.3.5, të Kapacitetit Teknik të DT-ve, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm: Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë: **1 (një)** Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor, me kapacitet jo më të vogël se 15 m³, në pronësi ose me qira; **1 (një)** Kamioncine transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo më pak se 3.5 ton, në pronësi ose me qira; **1 (një)** Makinë teknologjike larëse (autobot) me kapacitet jo më pak se 17 m³ në pronësi ose me qira; **1 (një)** Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrull, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m³ në pronësi ose me qira.

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë; - Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet: **a)** Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor); **b)** Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); **c)** Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) e vlefshme; **d)** Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit; **e)** Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme); **f)** Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen); **g)** Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij. - Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet: **a)** Kontrata e qerasë; **b)** Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); **c)** Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) (e vlefshme); **d)** Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit; **e)** Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme); **f)** Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen); **g)** Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij. - Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç’doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira). - Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme). - Operatori ekonomik duhet te deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës së makinerive. - Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkaktuar s’kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. - Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”. Kualifikimi i ofertës së Pastrime Silvio shpk është bërë në kundërshtim me kriterin e pikës 2.3.5 pasi nga verifikimi i ekstraktit tregëtar të QKB, rezulton se ky subjekt ka deklaruar se disponon vetëm dy makina teknologjike, ndërsa në kriterin e pikës 2.3.5 kërkohen që subjektet të disponojnë 3 dhe që të jenë të pajisura me dokumentacionin e përcaktuar në gërmat “a” – “g” kur janë në pronësi dhe “a” – “g” kur janë me qira. Nisur nga mungesa e deklarimit të 3 makinave teknologjike të deklaruar në QKB krijojmë bindjen se subjekti Pastrime Silvio shpk nuk e plotëson kriterin për disponimin e 3 makinave teknologjike

të pajisura me dokumentacionin e kërkuar në këtë pikë. Gjithashtu, nga verifikimet tona të bëra në deklaratimet që vet subjekti Pastrime Silvio shpk ka bërë në ekstraktin e regjistrit tregëtar të QKB, rezulton se ky subjekt nuk disponon një Kamioncine transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo me pak se 3.5 ton, të pajisur me dokumentacionin e kërkuar. Edhe në kushtet e marrjes me qira të kësaj komioncinë, ajo nuk disponon certifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi të lëshuar për qiradhënësin e cila të cilësojë se është e pajisur me Certifikatë Transporti për vetë dhe për të tretë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapacitetin teknik”, e modifikuar të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor, me kapacitet jo me te vogel se 15 m3,	copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncine transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo me pak se 3.5 ton,	cope	1 (nje)	Në pronësi ose me qira
3	Makinë teknologjike larëse (autobot) me kapacitet jo më pak se 17 m3	Cope	1 (nje)	Në pronësi ose me qira
4	Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qëndrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m3.	copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë;

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet :**
 - o) Dokumenti që vërteton pronësinë (certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - p) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - q) Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) e vlefshme

- r) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- s) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)
- t) Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen)
- u) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:**

- o) Kontrata e qerasë
- p) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- q) Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) (e vlefshme)
- r) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- s) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)
- t) Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen)
- u) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (**fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira**)

- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.

- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. **Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi.** Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*".

III.2.2. Në shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, Pjesa III “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” pika B “DEKLARATË “Për disoinimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disoinimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Shtojca 10 Formualri Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

- Informacione për nënkontraktorin

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Adresa: Rr. "Fatmir Haxhiu" (prapa ETC), Tirana
e-mail: info@pastrimesilvio.com

Mob: +355 68 205 4861



Do të thotë pastërti!!!

EN ISO 14001 – ISO 9001 – ISO 18001 – ISO 39001

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
"ANUAR" shpk	601540596	Do të mbështetemi në kapacitetin teknik-makinerite dhe pajisjet te subjektit ANUAR shpk.	Kriteri 2.3.5 i Kapacitetit teknik ku parashikohet "Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë: ... Makinë teknologjike larëse (autobot) me kapacitet jo më pak se 17 m ³ Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qëndrore rrual, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m ³ .

3: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Adresa: Rr. "Fatmir Haxhiu" (prapa ETC), Tirana
e-mail: info@pastrimesilvio.com

Mob: +355 68 205 4861



EN ISO 14001 – ISO 9001 – ISO 18001 – ISO 39001

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [x] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <u>99 punonjës</u> Profili i punonjësve Drejtuës teknik/Përgjegjës shërbimi – Anila Gishti, Olsi Muca Punonjës shërbimi - mbi 50 punonjës Shoferë - Adrian Ibrahimi, Ilir Plaku, Olsi Lulja, Bashkim Lulja etj Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë – Olsi Muca <u>Makineri e mjete</u> Po [x] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor, me kapacitet jo më pak se 15 m ³ – ne pronesi me targa AB654KH Kamioncine transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo më pak se 3.5 ton – ne pronesi me targa AA378RV Autobot uji >10,000 litra, në pronësi, me targa AA908TG Autobot uji >10,000 litra, mbështetje nga subjekt "ANUAR" shpk Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore(majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qëndrore rrual, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m ³ - mbështetje nga subjekt "ANUAR" shpk
Emri, Mbiemri Bule Allmuda Firma	



DEKLARATË ANGAZHIMI SI SUBJEKT MBËSHTETËS

Në cilësinë e subjektit mbështetës shoqëria "ANUAR" shpk, me numër fiskal 601540596, me adresë Republika e Kosovës, Prishtinë, Llukarë (p.n.), me përfaqësues ligjor z. Nazif Krasniqi, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal 1175564663, angazhohem nëpërmjet këtij deklarimi se mbështes operatorin ekonomik, shoqërinë "Pastrime Silvio" shpk, me NIPT K91413010N, në procedurën e prokurimit, e cila zhvillohet me datë 22.09.2025 me autoriteti kontraktor Bashkia Vlore, me objekt "Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum", me REF-58215-08-15-2025, me fond limit 27.910.435,00 (Njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, në kapacitetet specifikisht si më poshtë:

I. KAPACITET TEKNIK/AUTOMJETE PAJISJE

1. Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rru, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m3 targa 01-535-ZG, Marka SCHMIDT, Tipi COMPACT 200, me numër shasie WSVS5V2S161701809.
2. Makina për larjen e rrugëve (autobot), me kapacitet mbajtës jo më pak se 10.000 litra ujë, targa 01-886-UE, Marka Mercedes Benz, Lloji ACTROS 2541 L, me numër shasie WDB9302041K891280, ngjyrë e bardhë.

Kjo Deklaratë lëshohet me kërkesë të subjektit Pastrime Silvio sh.p.k në përmbushje të detyrimeve që përcakton neni 84 të ligjit të 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe VKM 285/2021 "Per rregullat e prokurimit publik".

Data e dorëzimit të deklaratës 22.09.2025

Shoqëria "ANUAR" Shpk

Përfaqësuesi ligjor

Nazif Krasniqi



B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [X] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/> <p>Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rru, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m3 targa 01-535-ZG, Marka SCHMIDT, Tipi COMPACT 200, me numër shasie WSVS5V2S161701809</p> <p>Makina për larjen e rrugëve (autobot), me kapacitet mbajtës jo më pak se 10.000 litra ujë, targa 01-886-UE, Marka Mercedes Benz, Lloji ACTROS 2541 L, me numër shasie WDB9302041K891280, ngjyrë e bardhë</p>
<p>Emri, Mbiemri <u>Nazif Krasniqi</u></p> <p>Firma _____</p>	

- Dokumentacioni fizik i operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 18441/2 prot, datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3125/3 prot, datë 13.11.2025, si shkresës nr. 936/1 prot, datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3125/10 prot datë 23.01.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionin prej 124 faqe dhe 1496 faqe të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK, ku ndër të tjera është dorëzuar edhe dokumentacioni për mjetet AB654KH, AA378RV, AA908TG, 01-886-UE, 01-535-ZG.
- Kontratë Qeraje me Nr. 10969 Rep, Nr. 2315 Kol, datë 15.10.2025, lidhur midis qiradhënësit shoqërisë "Anuar" SHPK dhe Qiramarrësit shoqërisë "Pastrime Silvio" SHPK, për marrjen me qera të mjeteve 1- Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m³ me targë 01-535-ZG. 2- Makinë teknologjike larëse (autobot) me kapacitet jo më pak se 10.000 litra ujë me targë 01-886-UE.
- Deklaratë e datës 14.10.2025 e operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK me objekt "Sqarim mbi dokumentacion e kontrollit teknik të mjeteve në Republikën e Kosovës", si më poshtë vijon:

Tiranë, më 14. 10. 2025

DEKLARATË

Drejtuar: Bashkisë Vlorë

Lënda: Sqarim mbi dokumentacionin e kontrollit teknik të mjeteve në Republikën e Kosovës

Të nderuar,

Shoqëria "Pastrime Silvio" sh.p.k., me seli në rrugën Fatmir Haxhiu, Tiranë, përfaqësuar nga Bule Allmuça, në cilësinë e administratorit, në mbështetje të Ligjit nr. 05/L-132 "Për Automjete" të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore që e zbatojnë atë, deklaron sa vijon:

Në territorin e Republikës së Kosovës, kontrolli teknik i mjeteve motorike kryhet nga Agjencia për Mjete Motorike (AMRKS) dhe qendrat e licencuara prej saj. Pas përfundimit të kontrollit teknik, për çdo mjet që rezulton i rregullt, rëshohet Certifikata e Rregullsisë Teknike, e cila vërteton kalimin e kontrollit dhe përshtatshmërinë e automjetit për qarkullim.

Kjo certifikatë mbahet dhe arkivohet pranë Qendrës për Kontrollin e Automjeteve dhe pranë njësisë që ka kryer kontrollin teknik, në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr. 05/L-132 dhe me standardet e Direktivës Evropiane 2014/45/BE. Pronari ose përdoruesi i automjetit mund të pajiset me kopje të certifikatës përmes kërkesës pranë qendrës përkatëse të kontrollit ose drejtpërdrejt pranë Qendrës së Kontrollit të Automjeteve.

Verifikimi i vlefshmërisë së kontrollit teknik pasqyrohet në lejen e qarkullimit të automjetit (ku firmoset dhe vuloset) dhe në regjistrin elektronik të automjeteve të mirëmbajtur nga Qendra e Kontrollit të Automjeteve. i cili përbën provë ligjore për kryerjen dhe vlefshmërinë e kontrollit teknik.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

PASTRIME SILVIO sh.p.k.
Administrator
*

- Shkresë nr SH-8027/1 prot, datë 19.04.20219, me objekt "Kthim Përgjigje" lëshuar nga Drejtoria e Transportit dhe e Trafikut Rrugor Bashkia Tiranë për subjektin "Pastrime Silvio" SHPK si më poshtë vijon:

TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E TRANSPORTIT E TRAFIKUT RRUGOR

Nr. prot. Sh-8027/1

Tiranë 18/04 /2019

Lënda: Kthim përgjigje

SUBJEKTIT "PASTRIME SILVIO". SHPK
Nj. Administrative Nr.2, Rr "Labinoti", Godina 2, Hyrja 11, Ap 53, Tiranë.

Ëndëruar znj. Bule Allmuça, Administratore.

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. prot. Sh - 8027, datë 02.04.2019 të depozituar pranë Bashkisë Tiranë, lidhur me pajisjen me çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet, ju sqarojmë se:

Në nenin 54, pika 1, shkronja "g" të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) si dhe shkresën e M.P.P.T.T nr. prot. 2082/1, datë 06.04.2009 mbi "Liçencimin e subjekteve që kanë në përdorim automjete për përdorim të veçantë" (APV) drejtuar Bashkisë së Tiranës, përcaktohet që:

"Automjet për përdorim të veçantë (APV) janë mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave". Këto mjete nuk çertifikohen për transport mallrash.

Sa më sipër, mjetet me targa AA 378 RV; AA 443 OH dhe AA 259 IA (APV), nuk pajisen me çertifikatë për transport mallrash brenda vendit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



III.2.4. Në nenin 2 "Qëllimi i ligjit" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public.*

III.2.5. Në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisorsocial e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.7. Në neni 41 pika 2 dhe 4 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“2. Kërkesat e vecanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë

me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.8. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”.

III.2.9. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.
2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.
3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.
4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.
5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.
6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.
7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.2.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.
2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:
 - a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
 - b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
 - c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 20të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me

originalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.” Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.12. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Rej” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK,

konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të tij të firmosur dhe vulosur, Deklaratë angazhimi nga subjekti mbështetës, ku për përmbushjen e pikës 2.3.5 në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kryer deklaratimet si në pikën III.2.3 të këtij vendimi. Duke qenë se operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, sipas vendimit të KVO-së është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në pikë 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr. 18441/2 prot, datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3125/3 prot, datë 13.11.2025, si shkresës nr. 936/1 prot, datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3125/10 prot datë 23.01.2026, ka dërguar dokumentacionin prej 124 faqe dhe 1496 faqe të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, ku ndër të tjera është dorëzuar edhe dokumentacioni për mjetet AB654KH, AA378RV, AA908TG, 01-886-UE, 01-535-ZG, bashkë me dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike në brendësi të të cilit gjendet dokumentacioni për përmbushjen e pikës 2.3.5 të kapacitetit teknik në kriteret e veçanta të kualifikimit. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, i cili pretendon se operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK nuk disponon mjetet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5 me dokumentacion përkatës duke e ballafaquar këtë pretendim me pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik në kriteret e veçanta të kualifikimit, me dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, si dhe dokumentacionin fizik të paraqitur nga ky i fundit në autoritet kontraktor për përmbushjen e kriterit të cituar më sipër, KPP gjykon, se referuar përmbajtjes së formularit përmbledhës të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK konkretisht në pjesën III “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” pika C Deklaratë “*Për disponimin e mjeteve/pajisjeve, makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, ka deklaruar në mënyrë të qartë me emërtim mjeti, targë, duke dhënë indicie mbi posedimin e tyre. Gjithashtu operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në bazë të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dokumentacionin e deklaruar më sipër i cili shërben si provë për vertetimin e deklaratimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, me qëllim përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit se në lidhje me sasinë e mjeteve të kërkuara dhe dokumentacionit shoqërues të mjeteve të deklaruara nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK ky operator nuk e plotëson kriterin 2.3.5, Komisioni verifikoi dokumentacionin e ardhur me shkresën nr. 18441/2 prot, datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3125/3 prot, datë 13.11.2025, si shkresës nr. 936/1 prot, datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3125/10 prot datë 23.01.2026 nga ku rezulton se operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK ka paraqitur fizikisht në autoritet kontraktor dokumentet si më poshtë:

- Leje qarkullimi me nr serial 0000000309476, për mjetin me targë AB654KH.
- Policë sigurimi me nr. 9445455 datë 19.06.2025 për mjetin me targa AB654KH me periudhë sigurimi deri në 24.06.2026;

- Certifikatë e kontrollit teknik për mjetin me targa AB654KH e vlefshme deri në 23.10.2025.
- Foto Mjetit.
- Taksa vjetore e mjetit me targa AB654KH e vlefshme deri në 19.08.2026.
- Leje Qarkullimi me nr TRDA2766617, për mjetin me targë AA378RV.
- Certifikatë pronësie e mjetit me targë AA378RV.
- Policë sigurimi me nr. 3357607 datë 01.07.2025 për mjetin me targa AA378RV me periudhë sigurimi deri në 02.07.2026;
- Certifikatë e kontrollit teknik për mjetin me targa AA378RV e vlefshme deri në 27.11.2025.
- Foto Mjetit.
- Taksa vjetore e mjetit për mjetin me targa AA378RV e vlefshme deri në 19.08.2026.
- Shkresa nr. SH-8027/1 prot, datë 19.04.2019 e Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor Bashkia Tiranë ku citon ndër të tjera se mjeti me targë AA378RV (APV) nuk pajiset me çertifikatë për transport mallrash brenda vëndit.
- Leje Qarkullimi me nr TRDA0603118, për mjetin me targë AA908TG.
- Certifikatë pronësie e mjetit me targë AA908TG.
- Policë sigurimi me nr. 0028710 datë 02.02.2025 për mjetin me targa AA908TG me periudhë sigurimi deri në 10.02.2026.
- Certifikatë e kontrollit teknik për mjetin me targa AA908 TG e vlefshme deri në 20.07.2026.
- Foto Mjetit.
- Taksa vjetore e mjetit e vlefshme deri në 21.07.2026.
- Deklaratë angazhimi nga subjekti mbështetës dhe Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit të subjektit mbështetës.
- Leje Qarkullimi me nr 2066656, për mjetin me targë 01-886-UE, si dhe vulën e kontrollit teknik e cila është e vlefshme deri më 14.03.2026.
- Foto Mjetit.
- Policë sigurimi me nr. 10938525 datë 14.03.2025 për mjetin me targa 01-886-UE me periudhë sigurimi deri në 14.03.2026;
- Leje Qarkullimi me nr 2066623, për mjetin me targë 01-535-ZG, si dhe vulën e kontrollit teknik e cila është e vlefshme deri më 20.12.2025.
- Foto Mjetit.
- Policë sigurimi me nr. 10813275 datë 20.12.2025 për mjetin me targa 01-535-ZG me periudhë sigurimi deri në 20.12.2025.

Së pari referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se për disponueshmërinë e mjeteve të pastrimit, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkuar disponueshmërinë e 4 mjeteve të ndryshme sipas pikës 2.3.5 të DST. Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 5 mjete nga të cilat 3 mjete në pronësi dhe për 2 mjete është mbështetur tek subjekti mbështetës “Anuar” SHPK. KPP konstaton se ky kriter përta i përketë pikpamjes sasiore përmbushet pasi 3 mjete janë deklaruar në pronësi nga vetë operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, ndërkohë që për 2 mjete është mbështetur në kapacitetet e subjektit mbështetës “Anuar” SHPK. KPP sjell në vëmendje se në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: “4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.” Në rastin konkret duke gjykuar se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Anuar” SHPK, lidhur me plotësimin e kriterit të mësipërm, KPP gjykon t’i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: “4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”. Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera duhet të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar kërkesë të cilën e plotëson pasi nga 4 mjete të kërkuara në total nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ky operator ekonomik ka deklaruar se 3 prej mjeteve i disponon në pronësi, ndërsa për 2 prej mjeteve është mbështetur tek subjekti mbështetës “Anuar” SHPK. Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera por janë përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur plotësohet nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” pasi ai është mbështetur tek subjekti mbështetës vetëm për 2 mjete nga 4 mjete që kërkohen në kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3.5. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK në procedurën e prokurimit, nga pikpamja sasiore e mjeteve rezulton se e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor.

Referuar pretendimeve të ankimuesit që të verifikohet nëse është paraqitur *Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen)* nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit më sipërcituar të paraqitur në autoritet kontraktor nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK vëren se për mjetin me targë AA738RV, është paraqitur “*shkresa nr. SH-8027/1 prot, datë 19.04.2019 e Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor Bashkia Tiranë e cila citon ndër të tjera se mjeti me targë AA378RV (APV) nuk pajiset me çertifikatë për transport mallrash brenda vëndit*”, duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesën e autoritetit kontraktor të përcaktuara në pikën 2.3.5 gërma “f” të kapacitetit teknik në kriteret e vecanta të kualifikimit.

Nisur nga pretendimet e ankimuesit i cili pretendon dokumentacioni shoqërues i mjeteve nuk është i plotë pra sikurse ka kërkuar autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5 ku thuhet se “*për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi ose qera, duhet të paraqitet: a) Kontrata e qerasë; b) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor); c) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); d) Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) e vlefshme; e) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit; f) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme); g) Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm) (Per kamiocinen); gj) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij*”. Referuar dokumentacionit më sipërcituar të paraqitur nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK në autoritet kontraktor me qëllim përmbushjen e kriterit 2.3.5 të kapacitetit teknik nuk rezultoi e provuar që të jenë paraqitur Taksat vjetore për mjetet me targë 01-886-UE, dhe targë 01-535-ZG, për rrjedhojë operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e plotë të kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.5 të DST në lidhje me mjetet duke mos përmbushur kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 të shtojcës 9/2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pjesë e dokumenteve të tenderit.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje, se në rast se operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110, pika 1 e LPP. Në nenin 110 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet se: “*1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet se: “[...]1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose

enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.. [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK qëndron pjesërisht.

III.3. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, Komisioni gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipërm në pikën III.2 rezulton se gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit, objekt shqyrtimi, duke përmbushur qëllimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-58215-08-15-2025 me objekt “Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum” me fond limit 27,910,435.00 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 287,085.32 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) euro pa TVSH, Kursi këmbimit 97.22 lekë, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Korsej” SHPK dhe “Pastrime Silvio” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet duke i skualifikuar ato.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

